



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 18.07.2018

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “HEKURUDHAT SHQIPTARE - REHABILITIMI I LINJËS HEKURUDHORE TIRANË – DURRËS DHE NDËRTIMI I LINJËS HEKURUDHORE PËR NË AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR TË TIRANËS”, NË KUADËR TË GRANTIT TË INVESTIMIT NGA FONDI I PËRBASHKËT EVROPIAN I BALLKANIT PERËNDIMOR”

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 18 korrik 2018, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare - rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë – Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”, me një grant investimi nga Fondi i Përbashkët Evropian i Ballkanit Perëndimor”, i propozuar nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenet 78, 81, 82, 83, pika 1, 100 dhe 121, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 68, të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 17, të ligjit nr.43/2016, datë 21.4.2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton projektligjin në cilësinë e komisionit përgjegjës, bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë z. Luci dhe zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë z.Shkreli.

Projektligji i miratuar në parim me vendimin e Këshilli të Ministrave nr.110, datë 23.2.2018, si dhe nënshkruar ndërmjet palëve më 9.5.2018, ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes së grantit në shumën 35 435 000, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare - rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë - Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”, i cili akordohet nga Fondi i Përbashkët Evropian i Ballkanit Perëndimor. Gjithashtu, marrëveshja synon zbatimin e projektit të detajuar hartuar në bazë të marrëveshjes së grantit të datës 13 mars 2015.

Granti, në shumën prej 35 435 000 eurosh, që do të akordohet nga BERZH, do të përdoret për:

- financimin e punimeve për rehabilitim të linjës ekzistuese dhe ndërtimin e linjës së re, në kuadër të projektit,
- shërbimeve të mbikëqyrjes së punimeve
- dhe mbështetjes për zbatimin e projektit

Zëra të Financuar nga Granti paraqiten më poshtë:

- Kontrata për punime për rehabilitimin e linjës Durrës-Tiranë (PTT) dhe ndërtimin e linjës së re hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës do të financohet në masën 32,935,000 euro,
- Shërbime të mbikëqyrjes së punimeve do financohen në masën 1,500,000 euro,
- Ndërsa, zbatimi dhe mbështetje për njësitë zbatuese do financohen në masën 1,000,000 euro.

Projekti parashikohet të përfundojë deri më 31.12.2020.

Objektivat kryesorë në drejtim të rezultateve lidhen me rehabilitimin e linjës ekzistuese hekurudhore nga stacioni qendror hekurudhor Durrës deri në vendndodhjen e ardhshme të Terminalit të Transportit Publik të Tiranës për një gjatësi 34.2 km dhe, gjithashtu, për të ndërtuar një linjë të re hekurudhore që lidh linjën kryesore me Aeroportin e Rinasit (gjatësi 4.7 km), duke përfshirë dhe degëzimet shtesë, respektivisht, për të lidhur linjën e re me Terminalin e Transportit Publik Tiranë si dhe me qytetin e Durrësit. Projekti parashikon, gjithashtu, ndërtimin e një terminali hekurudhor në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës si dhe instalimin e një sistemi të ri sinjalizues e telekomunikacioni, të integruar në sistemin e linjës hekurudhore Durrës - Tiranë - Rinas.

Zbatimi i projektit do të bëhet nga “Hekurudha Shqiptare”, sh.a., në cilësinë e njësisë së projektit, dhe do të mbështetet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Duke qenë se kjo marrëveshje do të ndihmojë në përmirësimin e sistemit hekurudhor në vendin tonë, duke siguruar një vlerësim të plotë financiar dhe ekonomik që do të lejojë investime të mëtejshme në hekurudha për periudhat afatmesme dhe afatgjata, Komisioni e miratoi atë me votat pro të shumicës së anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

RELATOR

KRYETARI

Rolant XHELILAJ

Erjon BRAÇE